

**AKTI I THEMELIMIT  
DHE STATUTI I SHOQËRISË “E-LE-MENTI” SHPK**

**THEMELIMI**

Neni 1  
Ortaku themelues

1.1 Shoqëria “E-LE-MENTI” SH.P.K. themelohet nga Ortaket:

Z. **Gianpaolo Santoro**, shtetas italian, lindur me 10.07.1972 ne Bisceglie (BA), Italia, rezident ne Via Solferino nr.32, Molfetta (BA), Itali, mbajtes i Leternjoftimit me Nr. YC0714440, leshuar me 04.11.2022 dhe e vlefshme deri me 03.11.2032 me zotesi te plote per te vepruar

Z. **Franco Magliocco**, shtetas italian, lindur me 19.03.1962 a Favara (AG), Italia, rezident ne Via Tramontana, Nr.43, Molfetta (BA) Itali, mbajtes i Leternjoftimit me Nr. YA9249166, leshuar me 12.04.2016 dhe e vlefshme deri me 11.04.2026 me zotesi te plote per te vepruar

**EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE**

Neni 2  
Emërtimi

2.1 Emërtimi i shoqërisë është “E-LE-MENTI” SH.P.K.

Neni 3  
Forma ligjore

3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjeter në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 4  
Baza ligjore

4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Aktin e Themelimit, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore.

Neni 5  
Kohëzgjatja e veprimtarisë

5.1 Veprimtaria e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj në Qëndrën Kombëtare të Biznesit (“QKB”).

5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është i pacaktuar.

Neni 6  
Selia

6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Qendra "Condor Center", kat i trete, zyra nr.67, Rruga e Kavajes, Tirane.

6.2 Shoqëria mund të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësimi si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.

6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

**Neni 7**  
**Emblema. Vula**

- 7.1 Shoqëria do të ketë emblemën dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.
- 7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjisacionit shqiptar.
- 7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përbajnë emblemën dhe vulën e saj.

**Neni 8**  
**Objekti**

- 8.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është:
- Konsulencë dhe asistence investimi strategjik dhe ligjore. Asistence dhe konsulencë delokalizimi ne Shqiperi te investimeve te huaja. Aktivitet publikimi, komunikimi, marketing, menaxhim faqesh web-i dhe krijim te tyre. Formim professional dhe menaxhim te burimeve njerezore.

Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblese se Ortakeve.

**Neni 9**

- 9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000 ALL (njeqind mijë ALL).
- 9.2 Kapitali ndahet në 2 (dy) pjesë.
- Ortaku themelues Z. Gianpaolo Santoro zoterues i nje kuote me vlore te per gjithshme 50 000 ALL qe perben 50% te kapitalit
  - Ortaku themelues Z. Franco Magliocco zoterues i nje kuote me vlore te per gjithshme 50 000 ALL qe perben 50% te kapitalit
- 9.3 Pjesa e kapitalit zotërohen 100% nga Ortaket.
- 9.4 Kapitali është shlyer tërësisht.

**Neni 10**

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

- 10.1 Kuotat e kapitalit mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - ç) dhurimit;
- 10.2 Pjesët e kapitalit mund të transferohen tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” me amendimet perkatese.
- 10.3 Vendosja e çfarëdolloj barre mbi pjesët e kapitalit në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Asamblese se Pergjithshme.

**Neni 11**  
**Rritja e kapitalit**

- 11.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Asamblese se Pergjithshme.
- 11.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të tjera të kapitalit nga ortakë të rinj. Ortakët e rinj pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Asamblese se Pergjithshme.

## Neni 12 Zvogëlimi i kapitalit

- 12.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni tregtar.
- 12.2 Propozimi i zvogëlimit do t'i paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar dhe administratorit të paktën 45 ditë përpara marrjes së vendimit nga Asambleja e Pergjithshme e shoqërisë. Eksperti kontabël dhe administratori do të shqyrtojnë propozimin dhe do t'i paraqesin Asamblese se Pergjithshme raportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.
- 12.3 Raporti i zvogëlimit të kapitalit do të miratohet me vendim të Asamblese se Pergjithshme të shoqërisë.

## ORGANET E SHOQËRISË

### Neni 13 Vendimet e Asamblese se Pergjithshme

- 13.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë merren prej Asamblese se Pergjithshme.
- 13.2 Vendimet e Asamblese se Pergjithshme përfshijnë kryesisht:
- Ndryshimin e selisë ose të emërtimit të shoqërisë;
  - Rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
  - Shitjen ose transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar palëve të treta;
  - Prishjen dhe likujdimin e shoqërisë;
  - Emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë;
  - Emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar, në qoftë se është e nevojshme;
  - Miratimin e bilancit të shoqërisë;
  - Transformimin e shoqërisë në formë të tjera.
  - Vendimarrjen per investime te reja ne fushen e pasurive te paluajtshme brenda apo jashte territorit shqiptar.

### Neni 14 Administrimi

- 14.1 Administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator ose një grup administratorësh që caktohen me vendim të Asamblese se Pergjithshme.
- 14.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqerinë dhe drejtojë punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me udhëzimet e Asamblese.
- 14.3 Administratori i shoqërisë eshte Z. Franco Magliocco, shtetas italian, lindur me 19.03.1962 a Favara (AG), Italia, rezident ne Via Tramontana, Nr.43, Molfetta (BA) Itali, mbajtes i Leternjoftimit me Nr YC0714440, leshuar me 12.04.2016 dhe e vlefshme deri me 11.04.2026 me zotesi te plote per te vepruar
- 14.4 Administratori është përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:

- Drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
- Përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëni me të tretët personalisht ose me përfaqësim;
- Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit;
- Përgatitjen e dokumentave në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zoteron;
- Të zhvillojë veprimtari të tjera të çdo lloj natyre për të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektit të saj.
- Administratori ka të drejtë për ta përfaqësuar shoqerinë në Shqipëri apo kudo jashtë saj tek palët e treta, insitucionë apo entitete publike ose private,
- Të lidhë, për dhe në emër të shoqërisë kontrata me palë të treta;

- Të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër që konsiderohet i nevojshëm përmbarëvajtjen e biznesit;
  - Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri përpara bankave të nivelistës së dytë dhe Bankes së Shqipërisë si dhe të kryej, në emër të shoqërisë cdo transaksion bankar,
  - Të hape dege ose zyre perfaqësimi, që konsiderohen te nevojshëm përbiznesin e shoqërisë.
- 14.5 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm përpesë vjet me të drejtë ripërtëritje ose deri në çastin e revokimit të tij me vendim të Asamblese se Pergjithshme.

### Neni 15 Viti finansiar

- 15.1 Viti finansiar i shoqërisë përpushton me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të cdo viti.
- 15.2 Si përjashtim, viti i parë finansiar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Zyrën e Tatim Taksave dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

### Neni 16 Bilanci. Kontabiliteti.

- 16.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Asambleja e Pergjithshme dhe duhet të përgatitet përtu paraqitur para organeve tatimore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.
- 16.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkësave të legjislacionit përkatës. Për operacione të veçanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të veçanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.
- 16.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Asamblese se Pergjithshme.

### Neni 17 Te Ardhurat. Dividendi

- 17.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezervë për realizimin e qëllimeve të biznesit të saj në përputhje me kërkësat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
- 17.2 Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së cdo ushtrimori, pas pagimit të tatimeve, mund të ndahen ndërmjet ortakëve në raport më pjesët që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë.
- 17.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe çdo ortak do të pergjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e ushtrimorit të parë deri në tre ushtrimorët vijues.

### Neni 18 Likujdimi

- 18.1 Prishja e shoqërisë vendoset me vendimin e Asamblese. 18.2 Me vendimin e Asamblese caktohet një likujdator ose një grup likujdatorësh që do të plotësojnë procedurat e likujdimit.
- 18.3 Likujdatori do të përgatisë raportin e likujdimit mbi gjëndjen ekonomike të shoqërisë, rrëth operacioneve të mëtejshme të likujdimit dhe kohën që nevojitet përfundimin e tij. Në përfundim të kësaj procedurë, Asambleja do të shqyrtojë bilancin përfundimtar dhe do të miratojë përfundimin e procedurave të likujdimit.

Neni 19  
Mosmarrëveshjet

19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

Tiranë, datë 11.09.2023

ORTAKET:

Franco Magliocco  
Gianpaolo Santoro

